# VLERAT EVROPIANE PËR INTEGRIMIN E SHQIPËRISË - ALB2EU

***"Nëse dëshironi të shkatërroni një komb mjafton të prishni sistemin e tij arsimor"*** (Asmara Shafqat)

**Qëllimet e projektit:**

- Rritja e ndërgjegjësimit dhe e kapacitetit të mësuesve dhe nxënësve mbi rëndësinë e Edukimit të Vlerave dhe Qytetarinë:
  - në zhvillimin personal, shoqëror dhe qytetar
  - në krijimin e një shoqërie globale, më mbështetëse, kritike dhe aktive
- Zhvillimi i kompetencave që ndihmojnë për të kuptuar se Edukimi i Vlerave rezulton nga puna ndërdisiplinore brenda dhe jashtë kontekstit shkollor;
- Mbështetja me metodologji të reja për zhvillimin e aftësive tekniko-pedagogjike në fushën e Edukimit të Vlerave;
- Promovimi i burimeve / instrumenteve teknologjike për të mbështetur proçeset e trajnimit, mësimit dhe mësimdhënies;
- Shkëmbimi i përvojave → shpërndarja tek kolegët, shkollat dhe OJQ-të e ndryshme.






## Fqinji i Derës Ngjitur

*Fleta e Mësuesit*

| | |
|---|---|
| Vlerat | Respekti, Njohuria, Toleranca |
| Baza ligjore | Nenet 1, 7, 11, 21, 22, 25, 26 (Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian); Neni 2 (Traktati i Lisbonës) |
| Qëllimet | ***Pedagogjike***: Reflektimi mbi rëndësinë e fqinjëve për jetesën në komunitet.<br>***Praktike***: Plotësimi i tabelës ku analizohen fjalët e urta në lidhje me fqinjësinë. |
| Pjesëmarrësit | Minimumi 3; Maksimumi 30. |
| Kohëzgjatja | 30 deri 45 minuta |
| Materialet | Fleta e aktivitetit për secilin student |
| Përmbledhje | Fillimisht, nxënësit reflektojnë individualisht mbi konceptin e "fqinjit": rëndësinë e tij dhe cila është marrëdhënia e tyre me fqinjët duke plotësuar fletën e aktivitetit të nxënësit.<br>Në një moment të dytë, çdo student ndan me klasën përfundimet e tij/saj, duke prezantuar rezultatet e fletës së plotësuar. |
| Shënime | Ndërkohë që nxënësit paraqesin reflektimet e tyre, mësuesi/ja mund të shkruajë temat kryesore për të mbështetur fazën e diskutimit. Sugjerohet të konsultohen faqet e internetit më poshtë për më tepër informacion rreth Ditës Europiane të Fqinjësisë - http://www.european-neighbours-day.com dhe rreth politikës së zgjerimit dhe fqinjësisë - http://europa.eu/abc/12lessons/lesson_3/index_en.htm. |
| Diskutimi | Mësuesi/ja duhet të analizojë me nxënësit temat e paraqitura prej tyre, duke moderuar debatin rreth çështjeve si:<br>*I njihni fqinjët në ndërtesën/lagjen tuaj? Sa mendoni se i njihni ata?*<br>*E konsideroni veten një fqinj të mirë me ta? Justifiko përgjigjet e tua.*<br>*Keni pasur ndonjëherë nevojë të kërkoni ndihmë nga një fqinj apo ndonjë fqinj ka kërkuar ndihmën tuaj? Nëse po, në cilat situata?*<br>*Si mund t'i lidhim këto çështje me rëndësinë e fqinjësisë së mirë në Bashkimin Europian?*<br>*Mund të flisni lidhur me ndonjë bashkëpunim të mirë apo të dobët në Bashkimin Europian? (eksploroni, për shembull, solidaritetin midis shteteve për të mbuluar borxhet, menaxhimin e kufijve dhe emigracionin, etj).*<br>*Nëse do të kishit rast të flisni me dikë nga një Institucion Evropian në lidhje me këtë çështje, çfarë do t'i thonit apo propozonit?* |




**Aktivitetet e Projektit - ALB2EU**

- Krijimi e Portalit Bashkëpunues për të mbështetur punën e zhvilluar gjatë projektit;
- Sigurimi i bazave për mbështetjen e zhvillimit të studimit pedagogjik, trajnimin e mësuesve dhe aplikimin e materialeve pedagogjike;
- Zhvillimi i studimit – *Vlerat Humane në Shqipëri;*
- Seleksionimi, adaptimi dhe përkthimi i aktiviteteve pedagogjike eksperimentale dhe interaktive;
- Trajnimi i mësuesve /pedagogëve dhe ndërmarrësve të OJQ-ve lidhur me edukimin mbi vlerat dhe qytetarinë evropiane;
- Vlerësimi dhe përdorimi i materialeve në projektet e ndryshme shkollore dhe në komunitet → shpërndarja e materialeve.


**Adresa Kombëtare e Postës:**
Rruga Mihal Grameno, n.º 2, Pall. 10, Shk.1 Ap. 7
Tirana, Albania
tlf: +351 96 457 5001 | email: instituti@ilidh.org

**Adresa e Shtabit Ndërkombëtar:**
Universiteti i Vlerave - Pallati i Marqueses
Rua do Castelo, 2640-468 Mafra, Lisbonë - Portugali
tlf: +351 261 810 450 | email: info@universidadevalores.org


www.universidadevalores.org

Instituti LIDH
Instituti Luzo-Ilir për Zhvillimin Njerëzor

VALUES UNIVERSITY
Discover the Universe Within You


Co-funded by the Erasmus+ Programme of the European Union
Jean Monnet Activities